



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
08.04.2025

Me datë 08.04.2025, u mbajt mbledhja e Këshillit Bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Edmond Ndou, Uarda Gjekaj, Bledianë Nika, Hilmi Lakti, Fatbardh Dama, Vjollca Petani, Erald Erkocaj, Armela Brahim, Mirsad Bashi, Ardit Taflaj, Hedije Nasa, Gëzim Galiqi, Alma Mehmetaj, Erlinda Kavaja, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Florian Bjanku, Izmira Rusi, Irena Shala, Artan Haxhi, Irma Kopliku, Valjeta Bajraktari, Eliona Shkreli, Elis Doçi, Ardit Behri, Gjenarin Kapcari, Rezarte Pode, Ardita Spahija, Suada Kopshti, Marina Duhani, Vjoleta Përndrecaj, Gloria Shllaku, Fatmir Vojvoda, Imeldi Sokoli, Muharrem Shkjau, Amila Lici, Plarent Anamali, Jetmira Rraboshta.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit **Z.Oltion Luli**

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. *Projektvendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Shkurt 2025”.*
2. *Projektvendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Mars 2025”.*
3. *Projektvendim: “Për miratimin e qirasë mujore për banesat sociale me qira në administrimin e Bashkisë Shkodër për vitin 2025”.*
4. *Projektvendim: “Për strehimin emergjent të familjes SH.M dhe të familjes O.H në (Banesat Sociale me qira për komunitetin Rom)”.*
5. *Projektvendim: “Për dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri”.*
6. *Projektvendim: “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit tip ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe distributorëve vendas dhe të huaj për shfaqjen e prodhimeve audiovizuale në Kinema “Republika”.*
7. *Projektvendim: “Për miratimin e kërkesës për transferim në pronësi, të pasurisë me Nr.2/170, Vol 9, faqe 140, ZK 8591 nga Ministria e Financave tek Bashkia Shkodër”.*



8. Projektvendim : “ Për dhënie pëlqimi, shtesa dhe ndryshime për shoqërinë aksionare “Bio Strajca”, në pronësi të Bashkisë Shkodër”
9. Projektvendim: “Për dhënien e të drejtës dhe caktimin e përgjegjësisë së menaxhimit, administrimit dhe mirëmbajtjes së plazheve publike të menaxhueshme për shoqërinë aksionare në pronësi të Bashkisë Shkodër me nipt M369240030 ”.
10. Projektvendim: “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025 e miratuar VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar dhe detajim të fondeve sipas aktit normativ Nr.5 datë 19.12.2024 të Ministrisë së Financave”.
11. Projektvendim: “Për miratimin e planit “Për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor në Bashkinë Shkodër për vitin 2025”.
12. Projektvendim: “Për miratimin e “Planit të përbashkët të menaxhimit të rrezikut nga zjarri” në kuadër të projektit “ Bulding Smart Forests” .
13. Projektvendim: “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025 e miratuar VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar”.
14. Projektvendim: “Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Shkodër për vitet 2026-2028”.
15. Projektvendim: “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 për Bashkinë Shkodër”.
16. Projektvendim: “Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2024 të Bashkisë Shkodër”.
17. Projektvendim: “ Për miratimin e memorandumit të bashkëpunimit mbështetje për zhvillim 2023-2024 projekti “Bashki të forta”- Bashkia Shkodër”
18. Diskutime jashtë rendit të ditës.

Kourumi i domosdoshëm është prezent në sallë, mbledhja deklarohet e hapur.

Para se të hidhet në votim rendi i ditës **Z.Bjanku** merr fjalën dhe shprehet në lidhje me pr/rregulloren për emërtesat e rrugëve dhe titujve të nderit, e cila tashmë ndodhet në sekretarinë e Këshillit bashkiak në dy variante. Ai kërkon të dijë pse ajo nuk është përfshirë në rendin e ditës së sotme. Ai shton se është bërë një punë e lavdërueshme, kjo rregullore është diskutuar në komisionin e posaçëm dhe mendon se ka kaluar shumë kohë dhe është e nevojshme që qytetarët të marrin përgjigje për kërkesa lidhur me objektin e kësaj rregulloreje.

Z.Luli pyet se kur është dorëzuar pr/vendimi me variantin final të rregullores?

Përgjigjet **Z.Bjanku** duke thënë se beson që kryetarja e komisionit ju ka informuar që kemi sjellë variantin tonë final tashmë prej tre javësh për të vënë në lëvizje një situatë që tashmë është bllokuar paradoksisht në lidhje me rregulloren.

Përgjigjet përsëri **Z.Luli** duke thënë se nuk ka asnjë situatë të tillë, asnjë bllokim. Ai shton se ka qënë iniciativë e jona për të hartuar një rregullore për këtë. Pr/vendimi që ju keni sjellë i ka kaluar zyrës juridike dhe sapo të shprehet ajo detyrimisht do ndjekim të gjithë procedurën për ta sjellë atë për miratim në mbledhjen e Këshillit.

Z.Bjanku përsëri thotë se meqenëse patëm precedentin e mbledhjes së kaluar me rregulloren e veprave të artit, pse të mos kalojë edhe kjo rregullore në këtë mbledhje.

Përsëri **Z.Luli**, sqaron se nuk kemi një variant final dhe akoma nuk është shprehur zyra juridike. Ju e dini që ka një procedurë për këtë.

Ndërhyn **Znj.Gjekaj** dhe jep përgjigjen e saj lidhur me datën se kur është dorëzuar drafti i kësaj rregulloreje. Ajo thotë se drafti është dorëzuar në korrik të vitit të kaluar dhe për këtë ju kemi vënë në dijeni me anë të një e-maili zyrtar dhe nëpërmjet një grupi të përbashkët në Whats-up. Ajo shton se para disa javëve ka dërguar edhe një e-mail tjetër në adresë të Këshillit bashkiak, për të cilin janë në dijeni të gjithë anëtarët e Këshillit, ku ka kërkuar të dijë pse është vonuar kaq shumë vendosja në dispozicion e këtij materiali administratës së bashkisë? Nuk ka patur asnjë përgjigje.

Tjetër ankesë e saj është se është bërë e disata herë që nëpërmjet e-mail zyrtar ka bërë kërkesa që duhet t'i kalonin administratës në lidhje me pyetje që ato kanë nga qytetarët, për shkak të pozicionit të tyre si përfaqësues. Ajo shprehet se nuk dëshiron që kjo të kthehet në precedent, i cili nuk lë aspak shije të mirë.

Z.Luli sqaron se ju si komision, në draftin e parë që keni paraqitur para një viti, nuk keni firmosur në cilësinë e anëtarëve të këtij komisioni ad-hoc, ka patur vetëm tre firma. Nga ana e sekretares së Këshillit është kërkuar disa herë që të firmoset ky draft dhe nuk është firmosur. Kjo ka sjellë edhe këtë zvarritje. Prej tre javësh është paraqitur një tjetër draft nga **Z.Bjanku** dhe **Z.Anamali**. Të dy këto variante do rishihen dhe do dilet me një variant final, i cili do i paraqitet komisionit për vlerësim dhe pastaj do kalojë në seancë plenare siç e kërkon procedura.

Hidhet në votim rendi i ditës, ku rezultojnë **36** vota Pro **0** Kundër **1** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet në miratimin e Procesverbalit të Mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak datë, 03.03.2025 sipas ligjit Nr.8480 datë, 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", neni 16 pika 2.

Ndërhyn **Znj.Gjekaj** duke sqaruar se ajo nuk do votojë për arsye se nuk ka qënë pezant në mbledhjen e kaluar.

Z.Luli shprehet se duhet të votojë me votë detyrimisht.

Hidhet në votim, Procesverbalit të Mbledhjes së kaluar ku rezultojnë **35** vota Pro **0** Kundër **2** Abstenim. **Miratohet**

Para se të kalohet tek pika e parë e rendit të ditës, fjalën e merr **Znj.,Pode** duke thënë se duke patur parasysh objektin e pesë pikave të para, ajo propozon se nuk është e nevojshme të relatohen nga administrata.

Të gjithë janë dakort për këtë, edhe kryetarët e grupeve politike shprehin dakordësi, prandaj kalohet në votimin e pikës së parë: *Projektvendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Shkurt 2025”*.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **38** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika 2. *Projektvendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Mars 2025”*.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **38** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 3. *Projektvendim: “Për strehimin emergjent të familjes SH.M dhe të familjes O.H në (Banesat Sociale me qira për komunitetin Rom)”*.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **38** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika e radhës: *Projektvendim: “Për miratimin e qirasë mujore për banesat sociale me qira në administrimin e Bashkisë Shkodër për vitin 2025”*.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **38** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika 5. e rendit të ditës: *Projektvendim: “Për dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri”*.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **38** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Para se të kalohet tek pr/vendimi nr.6, **znj.Duhani** kërkon fjalën dhe shprehet se meqenëse u miratuan 5 pikat jetësore për qytetarët e Shkodrës grupi i PSD-së i sheh pr/vendimet e tjera të paligjshme duke qënë se jemi në fushatë zgjedhore, prandaj ato nuk do marrin pjesë.

Z.Luli shprehet se kjo është në të drejtën tuaj.

Znj.Kavaja i kërkon zonjave të partisë Social Demokrate të mos largohen sepse nuk ka të bëjë aspak me fushatën politike por pr/vendimet prekim drejtëpërsëdrejti qytetarët e Shkodrës. Për më tepër duhet të ketë një reagim publik nga ana e tyre.

Znj.Shestani në emër të Kualicionit BF, kërkon 5 minuta pushim.

Pas pushimit të kërkuar nga kualicioni BF, **Znj.Shestani** shprehet se pasi shqyrtuan pr/vendimet e tjera të rendit të ditës, duke filluar që nga Bio Strajca, ku po i jepet kaq shumë tagër kësaj sh.a-je. Po ashtu po kërkohet që të kalohet një fond emergjence, fond i cili duhet për rastet e fatkeqësive natyrore. Sot ne nuk ndodhemi në të tilla kushte. Dhe në bazë të kodit zgjedhor nuk lejohet një gjë

e tillë. Ajo përmend këtu edhe pr/vendimin e raportit të vlerësimeve dhe të tavaneve buxhetore. Ajo shprehet se ato si koalicion nuk pranojnë të bëhen patericë e këtij Këshilli, prandaj nuk do jenë pjesë e këtij votimi.

Z.Luli thotë që rendi i ditës u votua nga ana e tyre.

Znj.Shala thotë se ata i shërbejnë vetëm qytetarëve të Shkodrës.

Znj.Petani ndërhyr duke thënë se këshilltarët e BF-së e kanë braktisur me kohë Shkodrën.

Këshilltarët e Kualicionit BF lënë sallën.

Znj.Mehmetaj merr fjalën dhe shprehet se kolegët e BF-së nuk braktisën sot vetëm sallën por braktisën edhe nevojat dhe kërkesat e qytetarëve. Ajo shton se ato nuk përfaqësojnë vetëm partinë e tyre por edhe interesat e qytetarëve të Shkodrës. Ne jemi këtu me votën e tyre. Për më tepër që arsyet që përmendi Znj.Shala nuk qëndrojnë pasi ne të gjithë jemi njohur tashmë me pr/vendimet dhe ato kanë të bëjnë me nevojat dhe problematikat e qytetit. Nuk duhet të harrojmë që jemi këtu për qytetarët dhe të mos e përdorim këtë për politikë.

Edhe Znj.Kavaja shprehet gjithashtu se së pari duhet ti kërkojmë falje qytetarëve të Shkodrës sepse po preken sot interesat e tyre, duke përmendur këtu shfrytëzimin e plazhit të Velipojës në prag të sezonit. Po përdoren politikisht interesat e qytetarëve. Ajo shton se shumë shpejt Zgjedhjet do mbarojnë dhe Shkodra dhe punët e kryera për këtë qytet do ti mbeten qytetarëve të Shkodrës.

Përsëri **Znj Petani** shprehet se kjo mbledhje u përdor për fushatë elektorale dhe se këshilltarët e BF-së kishin ardhur me këtë synim për tu larguar , prandaj braktisën sallën dhe qytetarët. Ne po punojmë çdo ditë dhe qytetarët po e shohin dukshëm se kush po punon për Shkodrën.

Z.Shkjau shprehet se zgjidhja nuk është të largohesh nga salla. Problemi nuk është largimi tyre. Ato duhet të tregojnë përgjegjësinë me votë, dhe të mos tregohen arrogantë.

Z. Ndou me keqardhje shprehet se kolegët treguan se atëherë kur duhet t'i dalim krah qytetarëve ato braktisën sallën. Për më tepër rendi i ditës, shton ai ka pika të cilat nuk kanë të bëjnë fare me fushatën zgjedhore.

Pyetje e diskutime të tjera nuk ka.

*Në mungesë kourumi Kryetari e Këshillit **Z.Luli** e deklaroi mbledhjen të mbyllur.*

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmblëdhur diskutimet e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër të datës 08.04.2025. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio. (DVD).

Procesverbali përmban 6 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

V.o: Ky procesverbal do miratohet nga anëtarët e Këshillit në mbledhjen e radhës së Këshillit bashkiak.

Sekretar

Sabina DANAJ



Zbardhi Pr/verbalin:

Irma Sulishti



KRYETAR

Olion LULI

